

EPPC Albania kërkon një *Deputy Marketing Manager* për klientin e saj, kompani e njohur ndërkombëtare që operon me filiale në vend dhe rajon.

Qëllimi kryesor i punës:

Kandidati ideal do të jetë përgjegjës për zhvillimin dhe zbatimin e strategjisë së marketingut të kompanisë në përputhje me strategjinë e Grupit. Ai/Ajo do të jetë përgjegjës për të gjitha eventet, fushatat dhe veprimtaritë e organizuara, me qëllim promovimin e imazhit dhe reputacionit të kompanisë, për të siguruar rritjen e bazës së klientëve.

Përgjegjësitë Kryesore:

- Përgjegjës për komunikimin e kompanisë së jashtmi përmes çdo kanali komunikimi (internet, media sociale, radio/TV, postë, etj) njoftime për shtyp, artikuj , intervista etj;
- Përgatit dhe është përgjegjës për planin vjetor, mujor dhe javor të veprimtarisë së kompanisë dhe buxhetin vjetor të marketingut;
- Udhëzon dhe bashkëpunon me menaxherët e Degëve gjatë përgatitjes së planeve të marketingut duke u siguruar që secila degë është furnizuar me materialet dhe artikujt e nevojshëm promovues të kompanisë;
- Suporton stafin e shitjeve duke u siguruar materialet e nevojshme promovuese tek partnerët/klientët e tyre duke përfshirë dhe modele specifike të fushatave dhe promocioneve;
- Mbledh të dhëna dhe hulumton për konkurrencën në treg, cmimet, produktet, fushatat e tyre, identifikon pikat e forta dhe të dobëta të kompanisë dhe propozon modifikime të produkteve;
- Bashkëpunon drejtpërdrejt me agjensitë e reklamimit dhe median për prodhimin e materialeve të marketingut dhe vendosjen e fushatave në TV/Radio;
- Kujdeset që çdo fushatë, promocion, event të marrë vëmendjen maksimale në marketingun dixhital.

Kërkesat për këtë pozicion janë:

- **Diplomë Universitare në Marketing/PR/Media/Komunikim;**
- Eksperiencë në pozicione të ngjashme jo më pak se 2 vjet;
- **Përvoja në fushatat e marketingut dixhital në Google Adword dhe mediave sociale;**
- **Të zotërojë shumë mirë gjuhën Angleze dhe MS Office;**
- Të jetë proaktiv, kreativ, me iniciativë dhe i apasionuar vecanërisht pas marketingut online.

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj duke ndjekur linkun:

aplikim.eppc.al

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj dhe dokumentet shoqëruese do të kualifikohen. Tek ne CV-ja juaj është e sigurt dhe trajtohet në konfidencialitet të plotë.